



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë, 16.04.2013
Nr. 0204-360

PËR: Ramadan Muja, Kryetar i Komunës së Prizrenit
Njazi Kryeziu, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Prizrenit

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË VENDIMIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT,
NR. 01/011-2914 të Pranuar me datë, 27.03.2013

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me nenin 82 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare Nr.02/2011 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, pas shqyrtimit të Vendimit nr. 01/011-2914 të miratuar me datën 06.02.2013 nga Kuvendi i Komunës së Prizrenit, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjit Nr. 04/L-144 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Akti juridik i listuar si vijon, ka efekt të plotë juridik.

- Vendimi nr. 01/011-2914 për dhënien në shfrytëzim me koncesion të sipërfaqes prej 13.695m² me qëllim ndërtimin e kompleksit Afarist Banesor Zona 3.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër & Ministër i MAPL

Kopje: Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm i MAPL-së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Dana, 16.04.2013
Br. 0204-360

Za: Ramadan Muja, Gradonačelnik Opštine Prizren
Njiazri Kryeziu, Predsedvající Skupštine Opštine Prizren

PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI ODLUKE OPŠTINE PRIZREN,
BR. 01/011-2914 Primiłjeno dana, 27.03.2013

Poštovani,

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave, u skladu sa sajim mandatom odredjenim u članu 82 Zakona br. 03/L-040 za Lokalnu samoupravu, dodatak XII Uredbe Vlade Br.02/2011 o poljima Administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posle razmatranja Odluke br. 01/011-2914 usvojene dana 06.02.2013 od Skupštine Opštine Prizren, **potvrđuje** zakonitost ovog akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom br. 03/L-040 za Lokalnu samoupravu i Zakonu br. 04/L-144 i Administrativnim Uputstvom br.16-2008 za isplatu Političkog osoblja u Opštinama.

Pravni Akt naveden u nastavku, ima puni pravni efekat.

- Odluka br. 01/011-2914 za davanje na koriscenje pod koncesion poversine od 13.695 m² u cilju izgradnje poslonvnog i stanbenog kompleksa Zona 3.

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamanik premijera & Ministar MALS-a

Kopje: Besnik Osmani, Generalni Sekretar MALS-a
Direktorima uprava MALS-a
Arhivi MALS-a

Në bazë të nenit 6 dhe nenit 7. të Ligjit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 12 pika c, nenit 14, alineja 1 dhe nenit 40, alineja 3, të ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 27 alineja 1, të Statutit të Komunës së Prizrenit, pas shqyrtimit të shkresës së MAPL për rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit nr. 01/011-13245, të datës 18 tetor 2012, Kuvendi i Komunës së Prizrenit, në mbledhjen e vetë të mbajtur me 21 shkurt 2013, morri këtë:

V E N D I M

PËR RIKONFIRMIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË PRIZRENIT, TË DATËS 18 TETOR 2012, Nr. 01/011-13249 MBI DHËNIEN NË SHFRYTËZIM-ME KONCESION TË PRONËS

Neni 1

Me këtë Vendim rikonfirmohet dhe pjesërisht ndryshohet Vendimi i Kuvendit të Komunës së Prizrenit, i datës nr. 01/011-13245 , të datës 18 tetor 2012, për dhënie në shfrytëzim-me koncesion të pronës me tekstin në vijim:

“Neni 1”

Aprovohet propozimi i komisionit Komunal për Vlerësimin e Ofertave për dhënie e Pronës Komunale në Shfrytëzim, ashtu që lejohet dhënie në shfrytëzim-me koncesion e pjesës prej 157m/2, të ngast. Kadastrale nr. 7068/2 ZK Prizren, prej sipërfaqes së përgjithshme 335m/2 , që evidentohet sipas Certifikatës nr.5402, si PSH KK Prizren, e pjesës prej 43m/2, të ngast. Kadastrale nr. 7083-1 ZK Prizren, prej sipërfaqes së përgjithshme 1555m/2 , që evidentohet sipas Certifikatës nr.5401 si PSH KK Prizren, e pjesës prej 55m/2, e pjesës të ngast. Kadastrale nr. 7084 ZK Prizren, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 688 m/2, që evidentohet sipas Certifikatës nr.5401, si PSH KK Prizren dhe pjesës prej 239m/2, të ngast. Kadastrale nr. 10994/1 ZK Prizren, prej sipërfaqes së përgjithshme 10517m/2, që evidentohet sipas Certifikatës nr. 5467 si PSH KK Prizren.

Neni 2

Ngastrat (pjesët) kadastrale e përshkruar në neni 1 të këtij vendimi që gjenden në vendin e quajtur “PRIZREN” pjesët e të cilave janë objekt i këtij koncesioni, sipas Certifikatave të pronës të datës 28/02/2013, janë në sipërfaqe të përgjithshme prej 13.695m2, dhe evidentohen si pasuri shoqërore.

Neni 3

Pjesët e Pronave në fjalë të përshkruara si në “nenin 1” dhe 2 të këtij vendimi, dhe atë sipërfaqja prej 493 (katërqindëntëdhjetë)m/2 nga sipërfaqja e përgjithshme prej 13.695m/2, jepen me qëllim të ndërtimit të kompleksit Afarist-Banesor Z-3, në përputhje të plotë me Planin Urbanistik E.5.6, E. 5.9 dhe një pjesë e kuadrantit F.5.2, nr.01/011-2341 të datës: 29.02.2012, të Qytetit të Prizrenit.

Neni 4

Afati Kohor për dhënie në shfrytëzim me koncesion të pronës Komunale, do të jetë konformë nenit 6 të Ligjit Nr.04/L-144, për dhënie në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së Paluajtshme të Komunës do të jetë për 99 (nëntëdhjetenëntë) vite.

Neni 5

Me Ndërtimin e Objektivit Afarist-Banesor Z-3, Komuna e Prizrenit, do ta zbatojë në tersi Planin Urbanistik nr.01/011-2341 të datës: 29.02.2012, përkatësisht do të përfitojë hapësira banimi në përputhje me standardet e ndërtimit.

Neni 6

AUTORIZOHET Kryetari i Komunës të hyjë në koncesion në pajtim me ligjet që janë në fuqi, për pronën e cekur dhe për qëllimet e cekuar në nenin 1 të këtij vendimi.

Neni 7

Me këtë vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Sektori i Çështjeve Pronësore Juridike dhe Avokati Publik Komunal.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit në Kuvendin e Komunës së Prizrenit dhe do të shpallet në "Kumtar".

KOMUNA E PRIZRENIT

Kuvendi i Komunës

Nr: 01/011-2914

Më:21 shkurt 2013

Prizren

**Kryesuesi i Kuvendit
Nijazi Kryeziu**

